



Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine -Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

01Ref.Nr. 59
Datë: 30.12.2021

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/01 mars 2019), nenit 10 paragrafi 1 dhe 51 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-033 për Produktet e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 21/05 dhjetor 2018), si dhe nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 12 të Rregullores nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, merr:

V E N D I M

1. Me këtë Vendim përcaktohet forma dhe përmbajtja e shenjës kombëtare të konformitetit për produktet e ndërtimit që përdoren në Republikën e Kosovës.
2. Shenja kombëtare e konformitetit (K) vendoset vetëm nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, sipas parimeve të përgjithshme për përdorimin e saj dhe rregullave të përcaktuara në Ligjin nr. 06/L-033 për Produktet e Ndërtimit.
3. Forma dhe përmbajtja e shenjës së konformitetit të Kosovës është përcaktuar në Shtojcën e cila është pjese përbërëse e këtij Vendimi.
4. Shenja kombëtare e konformitetit (K) vendoset në produktet e ndërtimit në pajtim me Ligjin nr. 06/L-033 për Produktet e Ndërtimit dhe aktet nënligjore përkatëse, të cilat kërkojnë vendosjen e shenjës së konformitetit në mënyrë që produktet të vihen në dispozicion të tregut.
5. Produktet e ndërtimit të cilat shënohen me shenjën e konformitetit të shteteve të tjera, lejohen të vendosen në dispozicion të tregut në Republikën e Kosovës vetëm kur ato produkte janë shënuar me shenjën e konformitetit të njohur me marrëveshje ndërkombëtare të cilën e ka ratifikuar Republika e Kosovës.

6. Inspektorati për mbikëqyrjen e tregut për produktet e ndërtimit duhet të sigurojë zbatimin e saktë të dispozitave që rregullojnë shenjën kombëtare të konformitetit dhe të ndërmarrë veprime të përshtatshme në rast të përdorimit jo të drejtë të shenjimit, përfshirë masat sipas nenit 49 të Ligjit dhe veprimet për zbatimin e dispozitave ndëshkimore sipas nenit 56 të Ligjit nr. 06/L-033 për Produktet e Ndërtimit.

7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres;
- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Industrisë;
- Doganës së Kosovës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit.

Shtojca

Shenja kombëtare e konformitetit “K”

1. Shenja kombëtare e konformitetit përbëhet nga iniciali “K” që merr formën e mëposhtme:

